



**SHKPKK**

Shoqata Kombëtare e  
Pyjeve dhe Kullotave  
Komunale

www.shkpkk.org

# Kuorora e Gjelbër



Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Tiranë (Viti i njëmbëdhjetë i botimit) Nr. 86, nëntor 2008 Çmimi 20 lekë

## Konferencë ndërkombëtare: Shqipëria rajon konkurrues



Me 21-22 nëntor në Hotel Mondial, Tiranë, u zhvillua Konferenca ndërkombëtare "Shqipëria: Rajone konkurruese nëpërmjet përdorimit me efikasitet të energjisë dhe mbrojtjes së resurseve natyrore".

Konferenca u organizua nga Fondacioni për Europën Juglindore i Ministrisë së Punëve të Jashtme Gjermane dhe Instituti Leibniz për Gjeografinë (Leipzig-Gjermani), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë. Udhëtimin fushor i

pjesëmarrësve u mbështet nga Drejtoria e Politikave Pyjore dhe e Kullotave, Projekti i Burimeve Natyrore, Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Fakulteti i Shkencave Pyjore, si dhe Shoqatat e Përdoruesve të

Pyjeve e Kullotave, Tregan e Sinaballaj.

Modelet e Treganit dhe ai i pyllit të Haverikëve, japin mesazhin e shndërrimit të tokave të degraduara, në pyje të rritur brenda një periudhe të shkurtër dhe tani po përdoren si për rekreacion, ashtu edhe si shkolla për shtimin e biomasës dhe uljen e shkallës së erozionit të tokës.

Veç drejtuesve e specialistëve të institucioneve të mësipërme, morën pjesë ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri Bernd Borchardt, zëvendësministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ndue Preka.



Në Qarkun e Elbasanit

## Takim i Shoqatës Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave Komunale

Në Sallën e Konferencave të Hotel International Skampa, Elbasan, me mbështetjen e organizatës holandeze për zhvillim SNV, u organizua takimi me temë "Transferimi i Pasurisë Pyjore të komuniteti fuqizon fermerët e varfër". Takimi synoi evidentimin e problemeve të dala gjatë transferimit të pyjeve e kullotave në Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Morën pjesë: Bordi i Shoqatës Rajonale të Pyjeve e Kullotave Komunale të Qarkut Elbasan, kryetarë të SHPKK-ve nga i gjithë Qarku, përfaqësues nga Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në katër rrethet e Qarkut, ambientalistë, specialistë pyjesh, përfaqësues nga Federatat e Pyjeve Tiranë, Dibër, Korçë e Kukës. Morën pjesë gjithashtu përfaqësues nga MMPAU, nga SNV Tiranë e Korçë, mediat qendrore e lokale, etj. Mori pjesë dhe foli edhe kryetari Këshillit të Qarkut Elbasan, Ardian Turku. Po botojmë materialin kryesor që paraqiti Ndrizim Çela, kryetar i Bordit të SHPKK, Elbasan (Faqe 2, 3).

Inxh. Fatmir Brazhda



## Java Evropiane e Pyjeve

Genci Hoxhaj

Për herë të parë në kontinentin Evropian, me 20 - 24 tetor 2008, u zovillua në Romë (Itali) "Java Evropiane e Pyjeve". Aktiviteti u zhvilluan në të gjithë Evropën, duke diskutuar rolin e pyjeve dhe të sketorit pyjor në luftën kundër ndryshimeve klimatike, duke siguruar burime energjie të rinovueshme dhe duke siguruar burieme ujore. Gjatë këtij evenimenti u vlerësua nevoja për marrjen e masave për përdorimin e të gjitha potencialeve të sektorit të pyjeve.

Në takim ishin mbledhur bashkë rreth 450 pjesëmarrës nga sektorët e pyjeve, ujit dhe shtëpive. Java shënoi takimin e parë në nivel hartimi politikash të sektorëve të pyjeve dhe ujit.

Lexoni në fq. 2



Evolucioni i Silvikuturës midis Ekonomisë dhe Ekologjisë dhe shanset e saj në vendin tonë

Prof. Dr. ANESTI POSTOLI

Faqe 4, 5

**BIOMASA SI BURIM ALTERNATIV ENERGJIE:**

**RASTI I PROJEKTEVE BIOMADRIA DHE BIOMALBA**

A. Segre; E. Kullaj; G. Molari; R. Preka; M. Vittuari

Faqe 6

**Rritja e koeficientit të përdorimit të materialit drunor neto ...**

Msc. Ing. DORIZ MARJANI

Faqe 7



www.shkpkk.org

# DUKURI TË VËREJTURA GJATË KALIMIT TË PASURISË PYJORE NË NJQV

NDRIÇIM ÇELA, Kryetar i Bordit të SHPKK, Elbasan

Për ta bërë sa me rezultativ takimin, për të dialoguar e sugjeruar sëbashku zgjidhjen e tyre, po sjell disa dukuri që janë venë në gjatë procesit të transferimit të fondit pyjor në Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV). Fillimisht dëshiroj të jap mesazhin e bashkëpunimit, të mos e shohim njëri-tjetrin në garë për të "rrembyer" secili copën më të madhe. Ne jemi këtu për të bërë avokatinë e pasurisë pyjore dhe të gjitha burimeve të tjera natyrore në të mirë të komunitetit e sidomos të përdoruesit real të tyre. Konkretisht.

Mendoj se megjithë arritjet, **ritmet e transferimit janë të ngadalta**, sepse:

\* Aktorët pjesëmarrës nuk e kanë ndjerë si duhet përgjegjësinë që kanë në realizimin e kësaj reforme të rendësishme për ekonominë dhe fermerin shqiptar.

\* Akoma nuk janë njohur ligjërisht kufijtë midis fshatrave, midis komunave po edhe midis rretheve.

\* Përdoruesit nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojë të drejtat e perdorimit apo pronësisë mbi ate pyll, kullotë apo te ndonjë burimi tjetër natyror.

\* ZRPP nuk kanë regjistruar në asnjë rreth transferimin e kësaj pasurie të madhe.

**Ka mangësi në kuadrin ligjor** lidhur me të drejtat e pronësisë e të perdorimit, si:

- Përqendrimi i kompetencave në organet shtetërore edhe për çështje që duhet t'i takojnë NjQV.

- Ka mospërputhje e mbivendosje kompetencash midis disa ligjeve për administrimin dhe kadastrën e pyjeve dhe kullotave komunale, për kundervajtjet, lejet mjedisore, gjobat e sidomos vjeljen e tyre.

- Të drejtat e perdorimit nuk janë te plota e te qarta për pyjet e kullotat që i jepen në perdorim fshatit dhe familjeve, sepse mungojnë dispozitat ligjore. Nuk mund ta zgjidhë problemin vetem VKM nr. 22 date 09.01.2008, sepse ai është vetëm vendim, por nuk është ligj.

- Nuk është përdorur i njëjti matës për transferimin e pasurisë pyjore në NjQV. Psh. në rrethin e Elbasanit vetem 4 komuna nuk i kanë marrë në pronësi pyjet e kullotat komunale.

Çfarë ligji është përdorur për këto komuna. Sipas vendimit të KM nr. 1077 date 18.06.2008 qarku i Elbasanit vë në dispozicion të AKKP 6464 ha pyje prodhues dhe po sipas këtij vendimi 1868 ha merren

nga fondi pyjore i nje komune, shifer kjo e barabarte me 51 % te tere fondit prodhues te pasurise pyjore qe ka kjo komune ose 29 % e totalit te qarkut, Për mendimin tone kjo nuk është e drejte por e penalizon komunën, duke i rrembyer gjysmen e pasurisë pyjore (ajo ka 35511 ha pyje e 180 ha kullota). Behet fjale për Komunen e Paprit. Si ky rast ka dhe NjQV te tjera por me dukuri te ndryshme.

Tjetër. Komunave malore me pyje pishë mesdhetare (objekte pyllezimi), cungishte lisi te zhvilluar, u është hequr e drejta e perdorimit, duke i lene nje siperfaqe te konsiderushme shtetit. Keshtu ndodh ne Gjinar, Shushicë, Gracen, Labinot Mal, Funar, Tunjë, Skenderbegas. Administrimi i ketyre siperfaqeve behet nga shteti, po ligji si e parashikon dhe a është i drejtë ky veprim? Ç'përfiton fermeri qe banon rrëze ketyre maleve? Si do të futet fermeri në ekonominë e tregut? Ç'tregon eksperienca e vendeve të tjera?

**Vërtetë shteti duhet te jete i fuqishem, po ai s'mund te jete i tillë me fermere te pafuqishem.**

Komuna Rrajcë ka probleme me pronësinë, ashtu si edhe Stebleva, Hotolishti, Tunja, etj.

Prandaj po ritheksojmë se "të drejtat e perdorimit nuk janë të qarta e të plota për të gjithë pasurinë pyjore në kuptimin e gjerë të fjalës" sepse:

- Mungojnë dispozitat ligjore, kriteret dhe rregullat e menaxhimit e te shitjes së materialeve drusore e jodrusore nga përdoruesit dhe shoqatat me qellim rritjen e të ardhurave të tyre.

- Mungojnë kriteret për kalimin e pasurisë pyjore nga perdorimi në pronësi te perdoruesve (ata i dine e i ruajne edhe vetë, por kriteret ligjore janë te domosdoshme).

- Mungon rregullimi me ligj i marrëdhënieve midis qeverise qendrore e NjQV, midis NjQV e perdoruesve (fshat / fis / familje) dhe Sherbimit Pyjor e pronareve private. Pra nuk ka struktura lidhese për keto probleme.

- Mungojnë kompensimet që duhet te marrin perdoruesit dhe shoqatat për kufizimet që behen nga ligjet për parqet kombetare, zonat e mbrojtura, pasurite ujore e minerale, zonat turistike deri dhe ushtarake, që ndodhen në territorin e tyre.

Shoqata Rajonale e Pyjeve dhe e Kullotave Komunale e Qarkut Elbasan edhe në takimet e tjera locale, si ajo që u zhvillua në shkurt



2008 me nismen e kryetarit të Keshillit të Qarkut Ardan Turku dhe zyres së kordinim zhvillimit pranë Qarkut, e ka ngritur zerin për keto probleme. Por ka nje kontradikte tepër interesante. Pranë qendres ka nje lob konservator, që i mbyll problemet dhe logjikën se janë ata me afer pasurisë pyjore me te gjithë perbersit e saj e po nuk u be ashtu si thone ata pasuria pyjore u shkaterrua. Por ekziston edhe nje lob tjetër, që është me tolerant, me liberal në gjykim, që thote se me afer se kushdo me pyjet, kullotat e çdo burim tjetër natyror, është fermeri me ineresat e tij. SHPKK e Qarku Elbasan vlerëson lobin liberal, që kerkon decentralizimin e pasurisë pyjore për t'u rritur e zhvilluar me tej kjo pasuri, për te nxjerre edhe përgjegjësitë e paleve ku rregullatori kryesor është shteti nepermjet ligjit.

Shembuj te ruajtjes e zhvillimit te pyjeve dhe pasurive tjera natyrore keto dy dekada ka shume. Hidhini nje sy grykes së Shkumbimit dhe shikoni se si është rritur e zhvilluar pylli, hidhini nje sy kalimit te ujërave te kthjellta e te embla dhe shikoni se si është zhvilluar trofta në rezervatat private, etj.

Në vazhden e ndikimit te shume aktiviteve që janë zhvilluar në kuadrin e Transferimit te Pasurisë Pyjore në NjQV, pa paragjykuar DSHP se edhe ato kanë bere shume pune në kushtet e nje mungese eksperience e te nje kuadri ligjor te plote, në shume komuna janë bere edhe gabime, si pasoje e përgatitjes se njeanshme te dokumentacionit nga DSHP. Shume kryetare komunash firmosen Procesverbalin e transferimit pa shkelur me kembë e pa pare me sy parcelat ose me mirë pasurine pyjore që do te merrnin në pronësi. Kjo edhe sepse kryetaret e komunave nuk e njihnin mire gjendjen e nuk janë specialiste pyjesh. Prandaj jemi sot në nje situatë "hidh e prit", si thote populli.

Natyrisht nje informacion nuk mund te evidentojte te gjitha problemet shqetsuese te pazgjidhura gjatë këtij procesi te thelle reformash. Por ajo që është më e rendësishme për ne duhet te jete edhe për aktorët e tjere, që marrin pjese në realizimin reformes në pyje dhe në teresi te burimeve natyrore. Siç thame që në fillim nuk duhet ta shohim njëri-tjetrin si kundërshtarë në garë se kush do te marrë copën e madhe. Të gjitha palet duhet të mendojnë për përdoruesit real të pasurisë pyjore. Ky është roli ynë sot. Nuk

duhet te flasim me dy gjuhe, te permbushim dy pale interesa, te hartojme dy ligje, te bejme dy marreveshje. Jo. Duhet te flasim me gjuhen e ligjit për pyllin, te permbushim interesat rajonale në perputhje me strategjinë e zhvillimit kombetar. Te kemi nje ligj për pyjet që t'i rezistojte kohës dhe te bejme nje marreveshje që te gjithë punojme për pyjet, kullotat, mjedisin e çdo burim tjetër natyror. Të gjitha keto arrihen kur bashkëpunimi vihet në çdo pike te programeve të punës sonë. Duhet gjetur rrugë për të administruar pasurinë pyjore atje ku ka vendin.

Botanisti i njohur Antonio Baldacci, këtu e një shekull më parë theksonte se zhvillimi i bujqësisë shqiptare lidhet edhe me problemin e pylltarisë. Por, ka një vështirësi nënvizonte ai: **"... vërtetimi i pronësisë së Pyjeve të Shqipërisë. Para së gjithash duhet stabilizuar se cilat janë në pronësi private, cilat në perdorim të përbashkët e cilat shtetërore, për të shmangur kundërshtimet që lindin me mijëra dhe nxjerrin vështirësi që nuk do të jetë lehtë për t'u kapërcyer nga qeveria"**.

Defektet në ligjin nr. 7501 date 19.07.1991 nuk duhet te perseriten në atë për pyjet. Te gjejme kodet mijeveçare (ato janë te pashkruara por veprojnë edhe sot e kesaj dite) te krijuara nga komuniteti në rrjedhen e shekujve për administrimin e pasurisë pyjore.

Mendimet e strukturave të nivelit të parë të NjQV, Shoqatat e PPKK dhe përdoruesit realë janë:

- Krijimi urgjent i strukturave në zbatim te VKM nr 22 date 09.01.2008.

- Të forcohet bashkëpunimi midis këtyre strukturave (NjQV – SHPKK - DSHP) për lehtësimin e procesit te transferimit te pyjeve e kullotave komunale në mënyrë organike.

S'mund te mohojmë arritjet në transferimin e pasurisë pyjore, por duhet te pranohet se jemi të vonuar në realizimin përfundimtar të këtij procesi.

Qeveria me vendimet e marra ka kryer vetem kalimin formal te pasurisë pyjore në NjQV por këtij veprimi nuk i është bashkëngjitur aktiviteti ligjor i shume strukturave, siç Agjencia e inventarizimit dhe regjistrimit te pronave te palujtshme, ZRPP e aktorët te tjere pjesëmarrës në realizimin e kesaj reforme.

Për të përfunduar mendojmë të marrim e zgjidhim sëbashku këto përgjegjësi:

# Java Evropiane e Pyjeve

Për herë të parë në kontinentin Evropian, me 20 - 24 tetor 2008, u zuvillua në Romë (Itali) "Java Evropiane e Pyjeve". Aktiviteti u zhvilluan në të gjithë Evropën, duke diskutuar rolin e pyjeve dhe të sketorit pyjor në luftën kundër ndryshimeve klimatike, duke siguruar burime energjie të rinovueshme dhe duke siguruar burieme ujore. Gjatë këtij eventi u vlerësua nevoja për marrjen e masave për përdorimin e të gjitha potencialeve të sektorit të pyjeve.

Në takim ishin mbledhur bashkë rreth 450 pjesëmarrës nga sektorët e pyjeve, ujit dhe shtëpive. Java shënoi takimin e parë në nivel hartimi politikash të sektorëve të pyjeve dhe ujit.

Faktorët kryesorë dhe mesazhet që lidhen me objektivat e Javës janë:

## Pyjet dhe ndryshimet klimatike

Ka më shumë karbon në pyje se në të gjithë atmosferën. Ka shtatë herë më shumë karbon në pyjet e Evropës se sa gazra që emetohen në atmosferë nga burimet njerëzore. Pyjet luftojnë ndryshimet klimatike, duke sekuestruar karbon nga atmosfera në pemë; e magazinon atë në drurë dhe zëvendësojnë materialet dhe lëndët djegëse që çlirojnë karbon në mënyrë intensive.

Ndërtimet dhe konstrukcioni i ndërtesave çlirojnë rreth 40 % të GHG, ndërtimet e gjelbra me material drusor të prodhuar në mënyrë të qëndrueshme do të reduktonin dukshëm emetimin e CO<sub>2</sub>.

Megjithatë pyjet janë të ekspozuara ndaj ndryshimeve klimatike, të cilat mund të shkaktojnë stuhi, zjarre, infeksione nga insektet dhe zbutjen e ngrohjes globale.

Pylltarët duhet të zhvillojnë dhe implementojnë strategji për adaptimin e pyjeve ndaj ndryshimeve klimatike.

## Pyjet dhe energjia

Energjia nga lenda drusore përbën 65 % të burimeve energjëtike të rinovueshme në Evropë. Dhe kërkesa po rritet në dritën e sunimeve të vendosura nga politkberësit. Vjelja e më shumë materiali drusor për të përmbushur kërkesat në rritje është e

mundshme nëse politkberësit, pronarët e pyjeve dhe industritë që mbështeten mbi pyjet dhe lëndën drusore punojnë së bashku. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i qëndrueshëm duhet të sigurojë: funksionet biologjike dhe rregullatore të pyjeve, duek përfshirë dhe klimën, përmbytjet e fatkeqësitë dhe pastrimin e ujit, i cili dhjet të jetë gjithmonë i mbrojtur.

## Pyjet dhe uji

Pyjet ndikojnë në sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore, p.sh duke rregulluar rrymat dhe duke filtruar buriemet ujore. Në të njëjtën kohë, disa praktika menaxhimi pyjesh mund të ndikojnë në cilësinë e ujit. Specialistët e pyjeve dhe të ujërave mund të punojnë së bashku për këto probleme, të zhvillojnë strategji të integruara të menaxhimit të territorit dhe skema të pagesës për Sherbimet e Ekosostemeve (PES).

## Të punojmë së bashku për pyjet

Organizatave të pyjeve të Evropës punojnë së bashku, duke vendosur partneritet midis

Inxh. Genci HOXHAI



UNECE, FAO, MCPFE EC dhe shumë institucioneve kërkimore, sektorit privat dhe organizata të shoqërisë civile.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve të Javës Evropiane, sektori i pyjeve si një i tërë po kërkon t'i ofrojë shoqërisë zgjidhje për problemet që lidhen me këtë sektor, duke njohur potencialin e plotë të pyjeve dhe shërbimet e tyre shumëfunksionale, të cilat mund të luajnë rol në rendesishem dhe te pazevendësueshem ne luften kunder ndryshimeve klimatike dhe ne promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit tonë.

Dhjetori, si muaj tradicional i pyjeve përreth 50 vite, krahas nxitjes se opinionit publik për pjesëmarrje dhe veprime direkte në shërbim të pyjeve, vitet e fundit ka shërbyer për të sjellë në vëmendje dhe personalitetet e kësaj fushe, specialistë që kanë dhënë kontribute dhe kanë shërbyer me përkushtim në pyje. Është kjo një traditë që duhet vijuar, pasi promovimi, sjellja në kujtesë e punës dhe kontributit të pylltarëve të spikatur, shërben jo vetëm për pasurimin e historikut të shërbimit pyjor, për t'u njohur nga studentët, nxënësit e pylltarët e rinj të këtyre emrave të nderuar. Ndoshta hulumtimi, qëmtimi më i thellë në jetën e tyre, publikimi i fakteve dhe arritjeve të tyre mund të jenë objekt i ndonjë punimi diplome, konference apo tubimi të pylltarëve.

Në këtë 80 vjetor të lindjes së tij po sjellim për lexuesit një personalitet me vlera të veçanta e kulmim në jetën dhe veprën e tij, por si "shpërblim" diktatura i mori jetën kur ishte në moshën më të mirë.

Bernard Laca është një emër thujase i panjohur për pylltarët tanë

ndonse ishte specialisti i parë shqiptar i doktoruar jashtë vendit. Ai u lind në Shkodër, më 1918, në një familje qytetare. Shkollën fillore e kreu në kolegjin Saverjan dhe mbaroi gjimnazin e Shkodrës me rezultate të larta. Iu akordua një bursë studimi në Universitetin e Firences, Itali, në degën e pylltarisë dhe studimet i kreu me rezeutate të shkëlqyera. Për një kohë të shkurter ai punoi në Firence dhe fiton gradën "Doktor i Shkencave Pyjore".

Si shumë intelektualë patriotë Bernardi kthehet në atdhe. Ai njihet me gjendjen e pyjeve dhe jetën e vendit nën pushtimin fashist. Në atë periudhë edhe Kosova thuhetse qeverisej nga qeveria e Tiranës. Mungesa e specialistëve të pyjeve ndjehej kudo në trevat shqiptare, por në Kosovë më tepër. Ai kontakton me strukturat qeveritare dhe në nëntor

## Në kujtim të personaliteteve të pylltarisë shqiptare

# Dr. Bernand Laca, i pari inxhinier pyjesh me titull

Gjon FIERZA, Specialist në MMPAU, Tiranë

të vitit 1941 emërohet shef i zyrës Pyjore për Kosovën, në Prishtinë, ku punoi tre vjet.

Pas çlirimit dhe ndarjes fatkeqe me Kosovën, në vitin 1945 emërohet specialist në sharrat e Kryeziut, Pukë. Është ky i pari specialist i lartë pyjesh që merret drejtperdrejt me teknologjinë e shfrytëzimit të pyjeve dhe me mekanizimin e këtij sektori, i cili po mbante peshën e rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta. Më pas Dr. Laca emërohet inspektor i përgjithshëm i pyjeve për zonën e Veriut. Prej këtej transferohet në Vlorë, ku me këmbënguljen e tij, veç të tjerave, vihen në punë sharrat e Llogarasë dhe teleferiku, të braktisura nga italianët.

Dr. Laca ishte inxhinier i talentuar sidomos për shfrytëzimin dhe mekanizimin e përpunimit të drurit. Kujtohet

edhe si pionier i organizimit dhe vënies në punë të stabilimenteve të para të sharrave.

Në tetor të vitit 1946, në Vlorë, arrestohet dhe pas një gjykimi të pakuptimtë, pushkatohet në moshën 28 vjeçare.

Këto permbledhëm shkurt për këtë shkencëtar të parë të pyjeve të Shqipërisë, nga biseda me profesor Osjen<sup>1</sup>. Emri i Bernardit është jo vetëm nder i pylltarisë shqiptare, por ai meriton një vend nderi në figurat e njohura të shkencës shqiptare.

<sup>1</sup> Çfarë shkruhet në këtë artikull janë fakte të ofruara nga Prof. Ahmet Osja, i cili i njeh mjaft mirë dhe i vlerëson së tepërmi personalitetet e pylltarisë shqiptare. Prandaj ai meriton vlerësimin dhe respektin e gjithë pylltarëve shqiptarë.

## Vijon nga fq. 2

1. Në strategjinë rajonale, sektori i pyjeve dhe kullotave të zerë vend me përparësi, në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar. Hartimi i një programi Rajonal për Pyjet e Kullotat Komunale mbetet ndër synimet më urgjente të stukturave perkatëse dhe të Shoqates Rajonale të PKK të Qarkut. Në këtë program të perfshihen objektivat e transferimit të pasurisë pyjore, si dhe strategjia e reformave, roli i shtetit, i qeverisjes vendore dhe i perdoruesve në mbarëshkrimin e pyjeve dhe kullotave të veta.

2. Do të ishte me vend përmirësimi i kuadrit ligjor, ku të parashikohen:

- Legalizimi dhe njohja e të drejtës së pronësisë tradicionale të pasurisë pyjore për pretenduesit realë (pronarët) dhe perdoruesit faktikë (familja, fshati, shoqata) dhe keto të pajisen me dokumente ligjore nga ZRPP.

- E drejta e mbarëshkrimit të të gjitha pasurive natyrore nën juridiksionin e NjQV (kafshë të egra, burime uji, përrenj, rezervuarë lokalë, lëndë inerte, peshku e bleta).

- Kalimin e specialistëve perkatës, fondeve, mjeteve e pajisjeve të nevojshme nga Sherbimi Pyjor në komuna, përpjesëtimisht me sipërfaqen që kalon, si dhe dokumentacioni kadastral, teknik e hartografik.

- Të drejtën e perdoruesit (fshati, familja, shoqata) për shitjen e prodhimeve mbi nevojat e veta, si dhe për të shfrytëzuar pyje e kullota shtetërore për të nxjerrë prodhime për shitje e sigurim të ardhurash për zbutjen e varfërisë, krahas krijimit të instrumentave finaciare dhe nxites për të mbështetur zhvillimin e pyjeve dhe të kullotave komunale, si dhe të pasurive të tjera natyrore në zonat rurale.

- Në aktet ligjore duhet të behet dallimi midis pyjeve e kullotave që mbarështohen nga komuna per plotësimin e funksioneve të veta (pasi të jene plotësuar nevojat e banoreve) për pyjet dhe kullotat komunale që administrohen nga fshati, familjet bujqesore, shoqata. Është e nevojshme të rishikohen kriteret për pyjet e kullotat e të çdo burimi tjetër natyror që kalohen në pronësi. Çdo fshat të kete pronat e veta mbi pasurite natyrore. Planet e mbarëshkrimit të hartohen e zbatohen në baze fshati dhe permbledheshet për komunën.

- Të krijohet dhe të funksionojë sa me shpejt Sherbimi Këshillimor Pyjor, veçanerisht për pylltarinë komunale.

- Gjatë përmirësimit të kuadrit ligjor të kihat parasysh perputhja midis ligjeve dhe prirja të jete përafrimi me ligjshmerine europiane e pse jo dhe botërore.

- Përmirësimi i kuadrit ligjor t'i nenshtrohet një pjesëmarrjeje të gjerë të institucioneve e të interesuarëve, perfaqesuesve të NjQV, të shoqatave e sidomes të perdoruesve.

- Megjithse është një kohë e shkurter e miratimit të ligjit për pyjet nga Parlamenti arrijme në konkluzionin se ai ligj nuk i parashikon të gjitha zgjidhjet për reformën që po kalojnë pyjet dhe pasurite të tjera natyrore. Prandaj, Shoqata Rajonale e Pyjeve dhe Kullotave Komunale e Qarku Elbasan propozon hartimin e një ligji të ri me tre krere kryesorë: (i) Mbarëshkrimi i pyjeve shtetërore në administrim të Shërbimit Pyjor, (ii) Mbarëshkrimi i pyjeve e të gjitha pasurive natyrore në pronësi të NJQV e të perdoruesve tradicionale brenda juridiksionit të tyre, (iii) Mbarëshkrimi i pyjeve private.

# EVOLUCIONI I SILVIKULTURËS MIDIS EKONOMISË DHE EKOLOGJISË DHE SHANSET E SAJ NË VENDIN TONË

Prof. Dr. ANESTI POSTOLI



Të ndodhur në një çast kritik të historisë së Silvikuturës në Shqipëri, por edhe gjatë, për shkak të ndryshimeve esenciale të ndodhura kudo vitet e fundit, mendoj se do të ishte koha e duhur të hapet në median e shkruar një diskutim i gjërë midis specialistëve të pyjeve të të gjithë vëndit për këtë problem duke e pare atë nga këndvështrime të ndryshme si edhe duke sjellë përvoja e ide edhe nga vëndet e zhvilluara me qëllim që të gjëndet një rrugëdalje nga mjegullnaja që ekziston në sektorin e pyjeve, të cilën të gjithë e konstatojmë dhe e shohim por s' dimë si ta lexojmë e trajtojmë. Pikërisht, nisur nga ky motiv, dëshiroj të jap disa mendime lidhur me evolucionin e shkencës bazë të specialitetit të pyjeve "Silvikulturës", e cila është e para që duhet t'u përgjigjet problemeve aktuale që ka vëndi në fushën e pyjeve. Këto mendime e kanë burimin tek përvoja personale shumëvjeçare në këtë sektor, por edhe te konstatimet dhe përvoja e kolegëve, të vëndit e të huaj.

Siç dihet evolucionin e silvikulturës në plan evropjan (sepse vetëm në këtë plan ai mund të shihet i plotë) ka ndodhur përgjatë një periudhe të tërë historike për shkak të veprimt të tre kërkesave të shoqërisë, që kanë pasuar historikisht njëra-tjetrën, por që kanë vepruar edhe të ndërlydhura me njëra-tjetrën:

1) Kërkesa për të marrë në një kohë sa më të shkurtër dhe me sa më pak shpenzime, një prodhim vjetor konstant nga pylli;

2) Nevoja për të përfutuar njohuri të reja tekniko-shkencore për trajtimin sa më të mirë të pyjeve, me qëllim që ata të plotësojnë në nivelin e duhur kërkesat që shtron koha;

3) Kërkesa për përjetësimin e pyllit si pasojë e konsolidimit të vetëdijes për rëndësinë ekologjike të tij, ekzistenca e të cilit e bën të jetueshme të sotmen dhe të mundshme të arthmen në planetin tonë.

Në fillimet e shekullit XX, në ndikimin e njohurive të reja në biologji dhe ekonomi, silvikultura deri atëhere e bazuar mbi përvojën, mori dimension të ri: u kalua nga koncepti empirik në atë shkencor. Parimet e "ekonomisë" dhe të "natyrës" (kështu e quanin atëhere ekonomistët ekologjinë që sa po lindte) së bashku me ato të fitogjeografisë së krahasuar, të fitosociologjisë dhe të analogjisë klimatike e pedologjike, shërbyen si baza studimi të qeverisjes së pyjeve. Në ato vite të një rinovimi të thellë, kërkuesit iu kushtuan me zell përcaktimit të modaliteteve tekniko-ekonomike, që ato të lejonin zbatimin në praktikë të kësaj mënyre të të parit të pyllit.

Nën ndikimin e ndryshimeve të tilla me kalimin e kohës silvikultura evoluoi, duke filluar me silvikulturën financiare e duke vazhduar me atë fitogjeografike mbi baza ekologjike e pastaj me atë natyralistike. Sot në plan evropjan tentohet drejt silvikulturës sistemike, e cila është një projekt që mbështetet nga pikëpamja teknike mbi një parim elementar sipas të cilit: "Çdo praktikë kulturore është pasojë logjike e praktikave kulturore të mëparshme dhe projekt i praktikave kulturore të së ardhmes". Aktiviteti kultural sot ka si objektivi "mosthjeshtësimin e struktues së pyjeve, konservimin e biodiversitetit dhe kompleksitetit të pyllit dhe respektimin e ekuilibrave bioekologjikë", duke përdorur metodën shkencore për të eliminuar gabimet dhe për të formuluar projekte të reja të praktikave kulturore. Afirmimi i këtij vizioni ka lejuar që pylli të shihet jo si një grumbull drurësh, por si një diçka unike apo si një sistem biologjik kompleks në të cilin çdo komponente biotike dhe abiotike ka një kuptim të saktë dhe luan një rol të përcaktuar mirë.

Le të shikojmë shkurtimisht, por me më shumë detaje, karakteristikat e këtyre fazave të evolucionit të silvikulturës, të cilat natyrisht u referohen së pari vëndeve ku lindën e u zhvilluan, duke dhënë njëkohësisht momentet e zbatimit të disa prej tyre (por jo të gjithave) edhe në pylltarinë shqiptare.

## Silvikultura financiare

Ka lindur në shekullin XIX në Gjermani kur si pasojë e kërkesave të industrisë u bënë prerje rrah në sipërfaqe të gjëra. Kjo lloj silvikulture, nëse nga njëra anë kotribuoi në zhvillimin ekonomik të Evropës Qëndrore e mbi të gjitha të Gjermanisë, nga ana tjetër nxori në pah rreziqet e një silvikulture të orientuar në mënyrë të tepëruar drejt maksimizimit të prodhimit drunor.

Silvikultura financiare bazohet mbi një sistem kultural të thjeshtësuar. Ajo parashikon krijimin e pyjeve të thjeshtë, njëmosharë e të renditur në klasa moshe. Trajtimi i tyre përfshin operacione të përcaktuara mire dhe të domosdoshme. Rallimet në pyje bëhen vetëm kur këto operacione janë financiarisht pozitive. Ciklet dhe turnet e prerjeve janë të lidhura me kritere thjesht financiare. Shfrytëzimi bëhet me prerje rrah dhe ripërtritja është artificiale. Kjo mënyrë e të konceptuarit të silvikulturës ka mbizotëruar për një kohë të gjatë, duke mënjanuar interesin për "kulturën e pyllit".

Për shkak të vonësës në zhvillimin e përgjithshëm e për pasojë edhe në atë pyjor, në vëndin tonë nuk u zbatua ndonjëherë një silvikulturë e tillë as si konceptim e as si praktikë pune. Në ato kohra Shqipëria akoma josovrane kishte vtëm pyje të virgjër.

## Silvikultura mbi baza ekologjike

Dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të njëzetë u zgjeruan mjaft studimet fitosociologjike, ekologjike dhe të gjenetikës pyjore, të cilat pastaj u bënë bazat e shkencës së silvikulturës. Teknikat kulturore duhej të ishin rezultante, nga njëra anë e kapacitetit operativ të punonjësve të pyjeve dhe, nga

ana tjetër, e rezultateve të eksperimentimeve shkencore shpesh afatgjata. Mbi këtë bazë u formulua postulati: "Kushteve klimatike analoge u përkasin pyje të krahasueshëm midis tyre, mbi të cilat është e mundur të aplikohen metoda kulturore të ngjashme, pavarësisht nga shtrirja dhe përbërja floristike e tyre" (Pavari 1940), i cili u bë një nga mbështetjet e silvikulturës mbi baza ekologjike.

Ky tip silvikulture nënkupton një inkuadrim në sensin ekologjik, të përhapjes dhe përbërjes së njësisve të mëdha të vegjetacionit pyjor sipas konceptit të identitetit ekologjik. Ajo kërkon një sistem kultural më kompleks nga ai i silvikulturës financiare. Në esencë në këtë rast bëhet fjalë për të ashtuquajturën silvikulturë e krahasuar. Kështu, nëse njihen faktorët makroskopikë të mjedisit, veçanërisht klima e toka dhe kërkesat e specieve, atëhere sistemet dhe metodat silvikulturore të aplikueshme në një pyll të dhënë, mund të përdoren edhe në një pyll tjetër që ka të njëjtën fizionomi, edhe pse nuk ka të njëjtën përbërje. Në këtë silvikulturë speciet përdoren në vëndin e duhur. Prerjet kulturore dhe ato të ripërtritjes bëhen sipas kërkesave të specieve. Nëse ripërtritja natyrale nuk ndodh, atëhere kalohet tek ajo artificiale. Shkurt, silvikultura mbi baza ekologjike parashikon formimin e pyjeve njëmosharë, të thjeshtë, por me një ose të shumtën dy specie sekondare, të renditur në klasa moshash tek të cilët kryhen një ose më shumë rrallime. Te kjo silvikulturë përdoren tri forma trajtimi: (i) prerje rrah, (ii) prerje rrah me breza syze ose me amësorë, (iii) prerje suksesive.

Nga ky tip silvikulture në vëndin tonë është aplikuar vetëm forma e tretë e trajtimit qysh nga vitet tridhjetë të shekullit të kaluar, nën drejtimin e specialistëve të huaj e sidomos të inxhinierëve të parë të pyjeve: I. Mitrushi, Ll. Treska e I. Nako të cilët nga kjo pikëpamje meritojnë të quhen "themeluesit e silvikulturës shqiptare". Niveli teknik, mundësitë financiare dhe relievi i vëndit tonë nuk lejonin të aplikoheshin dy format e tjera.

## Silvikultura natyralistike

Si pasojë e dështimeve të ardhura nga zbatimi i silvikulturës financiare, të teorizuar nga shkolla gjermane, duke filluar nga vitet tridhjetë të shekullit të kaluar silvikultura dhe mbarështimi filluan të orientohen drejt zbatimit të teknikave që kishin ndikim të ulët mbi mjedisin. Studimi i dukurive natyrale përbënte në këtë kohë një preokupacion qëndror për të përcaktuar drejtimet që duheshin ndjekur në kulturën e pyjeve. Ideja udhëheqëse e silvikulturës së re që po lindte konsistonte në atë që, duke përfutuar nga njohuritë dhe zbulimet e kryera në sektorë të tjerë të shkencës, të përkufizoheshin më mirë sistemet dhe metodat e qeverisjes së pyllit. Megjithatë, kjo silvikulturë, e cila u quajt natyralistike, mbeti gjithmonë e lidhur me teorinë e realizimit ekonomik. Ndryshuan sistemet kulturore dhe metodat e prodhimit, por aspektet financiare mbetën gjithmonë në plan të parë, edhe pse ndiqej marrja e një rente maksimale të tokës, teknikat kulturore në pyje nuk shkaktin dëmtime të dukshme, që të ishin si më parë shpesh të pakthyeshme. Pra, në kuadrin e kësaj

silvikulture ka patur një stabilitet të furnizimit me lëndë druri, por edhe një stabilitet të peizazhit. Trajtimi i pyjeve parashikonte një seri formash ndërhyrjeje, të cilat përshatashin në realitete të ndryshme. Ato mund të përmbliidhen në tre sisteme:

- I pari, përfshin prerjet suksesive në forma të ndryshme. Ciklet e prodhimit janë më të gjata se ato të silvikulturës financiare dhe të asaj mbi baza ekologjike. Ripërtritja është natyrale dhe realizohet në një kohë sa 1/6 e ciklit të prodhimit. Pylli që rezulton është njëmoshar dhe ka shtrirje të ndryshme.

- I dyti, karakterizohet nga prerje të kombinuara: prerje me të zgjedhur e prerje suksesive. Ripërtërira këtu është natyrale dhe shtrihet në një periudhë prej 5-7 vjetësh. Pylli që rezulton është i përzierë e shumëmoshar dhe përbëhet nga grupe që kanë shtrirje të ndryshme.

- I treti, mban parasysh prerjen me të zgjedhur, klasike. Ripërtritja është natyrale dhe e vazhdushme, ndërsa periudha e rikthimit është 8-12 vjet. Shpërndarja e drurëve sipas kategorive diametrike bëhet sipas një funksioni të tipit eksponencial. Diametri kufi i shfrytëzueshmërisë shkon 45-55 cm. Pylli që rezulton është i përzierë e shumëmoshar.

Në vëndin tonë gjatë periudhës 1940-1990, duke vënë në jetë parimet e silvikulturës natyralistike, u zbatua me mjaft sukses sistemi i parë i trajtimit të pyjeve, d.m.th. ai i prerjeve suksesive në forma e shtrirje të ndryshme, si në masivet e ahut edhe në ato të pishës së zezë, duke realizuar kështu vazhdimësi me mënyrën e mëparshme të trajtimit kur u zbatuan idetë e silvikulturës mbi baza ekologjike. Zbatimi i sistemeve të tjera të trajtimit, ku mbizotërojnë prerjet me të zgjedhur, ishte i pamundur në vëndin tonë për shkak të terrenit tepër malor dhe mundësive teknike të pakata në procesin e shfrytëzimit të pyjeve.

Silvikultura natyralistike ka qënë objekt i polemikave të ashpra, sidomos në Gjermani. Argumenti për të cilin diskutimi është bërë veçanërisht i ashpër ka të bëjë me diferencën midis dy mënyrave të të kuptuarit të kësaj silvikulture, të cilat emërtohen: e para "Silvikultura në përputhje me natyrën", ndërsa e dyta "Silvikultura afër natyrës". Sipas Leibundgut e para ka parasysh "një silvikulturë që i nënshtrohet në mënyrë absolute dhe verbërisht karakterit rreptësisht natyral të grumbullit pyjor". Nga ana tjetër, e dyta konceptohet "në frymën e kërkimit të një harmonizimi të forcave të prodhimit, duke përdorur gjërësisht mundësitë që ofron natyra", psh, duke punuar me një gamë të gjërë specimesh, ku përfshihen edhe ato ekzotike. Por në esencë edhe silvikultura natyralistike në të gjitha format e saj ndjek gjithmonë marrjen e maksimumit të rentës së tokës, pa lejuar diktatin e ekonomisë mbi mbarështimin dhe silvikulturën.

Me këto forma të të kuptuarit të silvikulturës dhe duke zbatuar këto sisteme trajtimit, të cilat përbëjnë esencën e asaj çka ne dimë në këtë fushë, erdhi pylltaria, si në plan botëror edhe në shkallë vëndi, deri në prag të shekullit XXI. Por dinamika e ndryshimeve të mbulesës së sipërfaqes së globit dhe e kushteve ekologjike në tërësi ka qënë e jashtëzakonshme 2-3 dekadat e fundit.

## Lamtumirë koleg

Papritur, u nda nga jeta tekniku i pyjeve Kujtim Bregu.

Kujtimi u lind me 10 prill 1950 në fshatin Tomorr i Madh, Komuna Vërtop, Berat. Arsimin fillor e kreu në fshatin e lindjes dhe atë shtatëvjeçar në Beratit. U diplomua teknik i mesëm pyjesh në Teknikumin Pyjor të Shkodrës me 1969.

Filloj punë teknik ne ndermarrjen pyjore të Beratit, ku punoi për gati 40 vjet. Kujtimi punoi me devotshmeri e perkushtim ne profesionin e bukur e te veshitë te pylltarit. Ka punuar në detyra të ndryshme; teknik e inspektor pyjesh, përgjegjës sektori në zona e sektorë të ndryshëm të DSHP Berat.

Duken se kanë kaluar shumë shpejt vitet e tani që u nda nga ne s'na besohet. Ai ka qënë një nga specialistët më të mire, që ka bërë ndryshime me punën e tij në administrimin e fondit pyjor në gjithë territorin e rrethit.

Kujtimi ndahet fizikisht nga ne, por dashuria, zemërbardhësia, respekti për shokët dhe profesionin do të ngelen në zemrat dhe mendjet tona përjetësisht.

Familja humbi njeriun e saj më të dashur, ne humbëm shokun, mikun, kolegun tonë më të mirë dhe një nga specialistet më me pervojë të shërbimit pyjor. Kjo dhimbje është ndërjerë nga të gjithë ata që e kanë njohur. Ndajme këtë dhimbje me familjaret, të afërmit dhe gjithë dashamirësit e tij ne Berat dhe me gjere.

Trupi dhe shpirti i Tij do te prehen nën hijen e Malit të Tomorrit, për të cilin punoi e i kushtoi gjithë jetën, e deshi sa qe gjalle dhe tani le te prehet i qete ne gjirin e tij.

Lamtumirë, shoku, vëllai e kolegu ynë i dashur Kujtim! Kolektiviteti tone te pylltareve do t'i mungosh, por do mbetesh gjate ne memorjen e tij per kontributet dhe vlerat qe pate.

**Sokrat Kërri, Safet Dule, Sabri Zyka, Abas Hyraj, Enver Perdita, Fatos Nako, Sefedin Mbrakulli, Bedri Ormeni, Beqir Sheti ...**



## U nda nga jeta veterani i pyjeve inxh. Jani Maçolli

Pra disa ditësh u nda nga jeta në moshën 78 vjeçare, pylltari veteran, një ndër drejtuesit kryesorë të pyjeve në qarkun e Elbasanit, inxhinieri Jani Maçolli. Jeta dhe veprimtaria e tij qe lidhur ngushtë me pyjet. Deri në fund të jetës ai iu perkushtua profesionit. Tek Jani Maçolli ka spikatur respekti dhe dashuria për punën dhe njerëzit, sinjeriteti dhe korrektesa.

Jani Maçolli u lind në shtator të vitit 1930, në Pleshisht të Pogradecit. Shkollimin fillesatar e mori në vendlindje. Në vitin 1948 kyeu një kurs për teknik pyjesh dhe u emërua përgjegjës i zyres pyjore të Pogradecit. Po atë vit ai u transferua në Ministrinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, si teknik i inventarizimit të pyjeve. Në vitin 1959 mbaroi me korrespondencë Teknikumin Bujqësor, degën e pyjeve në Golem të Kavajës. Në vitin 1969, po me korrespondencë, përfundoi Fakultetin e Inxhinierisë Pyjore, Tiranë.

Puna dhe veprimtaria e tij u shtrinë në disa rrethe dhe kudo profesioni i pylltarit ishte e mbeti pasioni i Janit, me të cilin ai lidhi

jetën. Në vitin 1956 ai transferohet dhe emërohet drejtor në Drejtorinë e Pyjeve të Elbasanit, që administronte edhe pyjet e Beratit.

Jani Maçolli është ndoshta rast unikal në detyrën e drejtorit jo vetëm të Elbasanit, por dhe të gjithë vendit. Ai e ka drejtuar atë ndërmarrje përreth 27 vjet. Në drejtim të kësaj ndërmarrjeje ai ka realizuar një numër të madh punimesh në pyje e kullota. Është puna drejtuese e Jani Maçollit, niveli i lartë teknik i dhjetra specialistëve në Elbasan, Gramsh e Librazhd, që realizuan pyllëzimet në Krastë, Mengel, Shushicë, Bishqem, Gramiturë, Llixha, Lip, Peqin, duke krijuar kurorat e qyteteve.

Jani Maçollin e ka karakterizuar një perkushtim i veçantë për punën, një mënyrë perfekte komunikimi me specialistët dhe punëtorët. Jani Maçolli edhe pas daljes në pension qe një vprimtar aktiv. Ai interesohej për mbarëvjtjen e sektorit të pyjeve, merrte pjesë në takime e debate. Jani nënvizonte

**Vezir Muharremaj, Gramos Llanaj, Nihat Dragoti, Kozma Kocani, Ahmet Mehmeti, Aleksander Rama, Gjon Fierza, Prend Bardhi ...**



dhe vazhdimisht kërkonte nga opinionin se "Pyjet nuk mund t'i ruajnë vetëm pylltarët, atë u shërbejnë të gjithëve, prandaj pyjet nga prerjet dhe zjarri duhet të mbrohen nga të gjithë. E gjithë njerëzia duhet te ngrihet kur del tym nga pylli, nuk ka nevojë t'u bëhet thirrje. Çdo dru është një jetë, zjarri e shuan atë, pra duhet vrapuar e sakrifikuar për të shpëtuar këto jetë. Shuarja e jetës së drurëve çon në shuarje të jetës tonë ...

Shkurt thamë diçka për Jani Maçollin, për të sjellë në kujtesë, për të vlerësuar punën dhe veprimtarinë e tij kur ai nuk jeton më. Jani Maçolli e lidhi jetën me pyllin, iu perkushtua tërësisht atij. Ai do mbetet gjatë në kujtesën e kolegëve e bashkëpunëtorëve jo vetëm në Elbasan or edhe më gjerë.

### Vijon nga fq. 4

Në shkallë planeti mijra hektarë pyje zhduken çdo ditë nga shpyllëzimet, miliona metërkub tokë çohet në det nga erozioni, miliarda metërkub gaz karbonik çlirohen në atmosferë nga industria, ndërsa tek ne për më tepër prishet struktura tradicionale e qeverisjes, trajtimit dhe administrimit të pyjeve, duke ndryshuar si konceptimi edhe objektivat e mbarështimit të tyre, ndryshon rrënjësisht sistemi i pronësisë, etj. Të gjithë këta faktorë, por edhe shumë të tjerë, krijojnë edhe për pyllin dhe shkencën e tij, silvikulturën, një situatë të veçantë emergjence, e cila ka nxitur mendjet më të ndritura të kësaj fushe të kërkojnë zgjidhje, duke hedhur në fushën e lojës idetë e një projekti të ri, atë të silvikulturës sistemike.

### Silvikultura sistemike

Në fakt, lindja e vetëdijes që pylli është një sistem biologjik kompleks në gjëndje të vetorganizohet, çoi në konceptin e silvikulturës sistemike. Pylli është sistem i karakterizuar nga një organizim dhe strukturë me përmbajtje të lartë informacioni, sistem që përbëhet nga një numur i madh elementësh që ndërveprojnë midis tyre. Marrëdhëniet e brendshme lidhen me një rrjet të jashtëm më të gjërë marrëdhëniesh. Loja e ndërveprimeve është proces gjithmonë aktual, i cili bën të lindin konceptet e pasigurisë, papërcaktueshmërisë dhe paplotshmërisë tipike për gjithçka që është kompleks.

Në planin teknik, silvikultura klasike (me këtë emërtim përmbledhim të gjitha llojet e silvikulturës të shpjeguara më sipër) ka përpunuar metoda të kultivimit të pyllit, që lejojnë ripërtëritjen e grumbullit sipas një

modeli të parashikuar. Silvikultura sistemike përkundrazi, nënkupton një pyll të pastruar, pra johomogjen. Ndërhyrja kulturele ka synim të ndihmojë mekanizmat, që lidhin pjesët e ndryshme të sistemit, duke favorizuar ndërveprimet midis tyre dhe mjedisit.

Objekti i silvikulturës sistemike është efikasiteti funksional i ekosistemit. Operacionet kulturele nuk ndjekin skema specifike; ato bëhen sipas nevojave të grumbujve, me qëllim që të lehtësohet ripërtëritja natyrale e vazhdueshme dhe e kudogjendur. Monitorimi bioekologjik i efekteve të reagimit të grumbujve ndaj ndërhyrjeve është mjeti që tregon se ku duhen bërë korrigjimet eventuale. Vjelja e lëndës së drurit te kjo silvikulturë bazohet mbi kriterin minimal, gjë që lejon që edhe në kushte të ndryshme stacionale, të përbërjes, strukturës dhe kërkesës reale të grumbujve të veçantë, të mund të konservohet e shtohet biodiversiteti dhe kompleksiteti i sistemit. Silvikultura sistemike parashikon pyje të përzierë, që nuk paraqesin strukturë të përcaktuar në hapësirë dhe në kohë, d.m.th. që nuk karakterizohen as nga struktura njëmoshare, as nga ajo shumëmoshare e aq më pak nga ajo që shpesh e quajmë strukturë e çregullt. Motivi i silvikulturës sistemike është: "çrregullshmëria alternativë e rregullshmërisë". Silvikultura sistemike nuk tenton drejt formave strukturale të rregullta, por as edhe atyre të çrregullta. Pyjet e trajtuar sipas kriterëve udhëheqës të silvikulturës sistemike përbëjnë silvosisteme në ekuilibër të qëndrueshëm me mjedisin. Edhe pse jo plotësisht e kristalizuar, rëndësi ka të kuptohet se bota e qytetëruar me silvikulturën sistemike kërkon të gjejë në kushtet e reja rrugëzgjidhje të përshtatshme edhe në fushën e pyjeve e të mjedisit.

Natyreshëm lind pyetja: A mendohet edhe tek ne se silvikultura e zbatuar deri tani është e pamjaftueshme, se gjetja e rrugëve të reja për të dalë nga situata kërkon vlerësim të rezultateve pozitive të deritanishme, shfrytëzim të arritjeve bashkëkohore të shkencës, eksperimentim dhe kërkim të thelluar, të cilin duhet ta bëjnë në radhë të parë specialistët më të kualifikuar e me më shumë përvojë, se çdo ndryshim në strukturën e organizimit, qeverisjes, mbarështimit e trajtimit të pyjeve duhet bërë mbi këtë bazë, etj.? Edhe pse nuk na vjen mirë ta themi, tek ne, në vënd të kësaj, konstatohet kthim në empirizëm, kur mendohet e besohet se komunat dhe bajraqtet do t'i qeverisin e trajtojnë më mirë pyjet nga ç'mund t'i trajtojë një ndërmarrje e specializuar, kur kërkimi shkencor është joekzistent dhe termi "menaxhim" ka zëvendësuar gjithçka, kur silvikultura konsiderohet koncept thuasje i panevojshëm ndërsa mbarështimi herezi.

Në këto kushte edhe pse sot në nivel planeti, sidomos në vëndet në zhvillim (por jo në ato të zhvilluara) shpyllëzimet shtohen me ritme eksponenciale, ndërsa pylli trajtohet jo si burim i rinovueshëm, por si minierë nga e cila mund të marrësh prodhim sa të duash deri sa ai të mbarojë, kurrë si sot nuk është tërhequr vëmëndja e eksponentëve kryesorë të politikës botërore ndaj problemeve mjedisore e të shpëtimit të pyjeve. Jo rastësisht sot konceptit të qeverisjes (por jo menaxhimit) të pyjeve i shtohet mbiemri "e qëndrueshme" të cilit më vonë (mbas konferencës së Rios-1992 dhe asaj të Helsinkit-1993) i shtohet edhe loncepti i biodiversitetit.

Në vëndin tonë qeverisja e pyjeve është në udhëkryq. Nga njëra anë inkopetencia e

komunave që s'dinë ç'të bëjnë me pyjet, që u thonë se kanë marrë në përdorim (pronësi), kurse nga ana tjetër kërkesat e ekonomisë ndaj pyllit sepse nuk duhet harruar se ndërsa gjysma e popullsisë jeton akoma në fshat, pra e ka të bazuar jetën e saj, sidomos në zonat malore, me pyllin, në qytet konsumi i lëndës së drurit për ndërtim dhe djege vjen duke u rritur. Në mënyrë të natyreshme lindin pyetjet: Me ç'mjete dhe si do t'i realizojë këto kërkesa ekonomia pyjore, si do të realizohet përjetësimi i pyllit si kusht i patjetërsueshëm i jetës si kudo edhe në vëndin tonë, kush dhe si do të tentojë të futë në pylltarinë shqiptare idetë e silvikulturës sistemike, ç'duhet të bëjnë komunat, si duhet strukturuar ekonomia pyjore në kushtet e reja, cilat do të jenë objektivat dhe kërkesat ndaj saj, etj.?

Këtyre pyetjeve, që preokupojnë të gjithë botën e që duhet të na preokupojnë edhe ne, nuk është e lehtë t'u përgjigjesh. Për më tepër, diskutimi i tyre i vazhdueshëm është një nevojë pa të cilën nuk mund të gjenden zgjidhje. Prandaj, ato duhet të bëhen një argument i përbashkët për të gjithë politikanët, punonjësit e pyjeve, studiuesit, teknikët, por edhe drejtuesit e komunave, të cilët duhet të kuptojnë se loja është e hapur, problemi i pazgjidhur e mjegulla e pashpërndarë. Është e nevojshme të bëhen llogaritë me një epokë të re të planifikimit dhe të qeverisjes së pyjeve idetë orientuese të së cilës mbeten për t'u formuluar gjithmonë në përputhje me: (i) arritjet e shkencës në plan botëror, (ii) qëllimet që ekonomia jonë pyjore i ka vënë vetes, (iii) përvojën dhe nivelin shkencor të pylltarisë shqiptare.

# BIOMASA SI BURIM ALTERNATIV ENERGJIE: RASTI I PROJEKTEVE BIOMADRIA DHE BIOMALBA

Andrea SEGRE; Endrit KULLAJ; Giovanni MOLARI; Rovena PREKA; Matteo VITTUARI

## 1. Hyrje

Burimet e energjisë alternative kane zënë një hapësirë të madhe në debatin shkencor dhe politik të viteve të fundit për shkak të vështirësive të vazhdueshme teknike dhe politike që kane të bëjnë me furnizimin e energjisë dhe problemet mjedisore të lidhura me to. Artikulli nisët nga disa konsiderata mbi administrimin energjetik evropian dhe ndërkombëtar për të trajtuar me pas dimensionin rajonal duke analizuar disa eksperiencat të zhvilluara në Pellgun Adriatik – Jon.

## 2. Administrimi dhe nevoja energjetike

Me 2 janar 2008 çmimi i një fuçje naftë arriti vlerën e 100 dollarëve, duke shënuar një rekord historik në terma nominale (101,7 dollarë). Sipas parashikimeve të analistëve të sektorit prirja që shkaktoi një rritje prej 58 % e regjistruar në vitin 2007, synoi të vazhdoje edhe gjatë gjithë vitit. Në rritjen e vazhdueshme të çmimit, përveç spekulimeve të zakonshme financiare, ndikoi edhe rritja e kërkesës, kundrejt një oferte që vazhdon të mbetet e pandryshueshme. Rritja konstante është konfirmuar edhe nga organizata kryesore ndërkombëtare të sektorit IEA (International Energy Agency) parashikimet e se çiles tregojnë që brenda vitit 2030 kërkesa e energjisë e nxitur kryesisht nga rritja e ekonomive emergjente të Azisë dhe Amerikës së Jugut, do të shkojë përtej 50 %.

Por furnizimi nuk është i vetmi problem që karakterizon administrimin energjetik. Energjia nuk është e izoluar nga ambienti, kështu që, paralelisht me rritjen e mundshme të përdorimit dhe kërkesës energjetike, rrezikohet shtimi i pasojave negative në mjedis. Gjithmonë sipas IEA-se, sistemi energjetik botëror do të vazhdojë të jetë i zotëruar nga lende djegëse fosile dhe teknologji me pak efektive; çlirimet në atmosferë të CO<sub>2</sub> në shkallë planetare brenda vitit 2030 do të rriten rreth 60% kundrejt nivelit të vitit 1990.

Kërkimi i burimeve fosile alternative është një nder sfidat kryesore që karakterizojnë sot dhe në dhjetëvjeçarën që vjen administrimin botëror, si në tentativën për të garantuar një disponibilitet energjetik të përshtatshëm, si në kërkimin e përgjigjeve të problemeve që kane të bëjnë me ndryshimet klimatike.

Pikërisht në këtë kuadër pozicionohet interesi i madh që kërkimi shkencor dhe bota politike po i japin prodhimit të energjisë nga biomasat.

## 3. Parashikime e Druajtje: debati mbi biomasat

Vitet e fundit pritet gjithnjë e më shumë (duke pasur parasysh investimet dhe nxitjet) nga biomasat, të cilat konsiderohen shpesh si burimi i se ardhmes meqë kanë rol themelor në sigurinë e furnizimit energjetik, në dekarbonizimin e lendeve djegëse për transport dhe në zbulimin e mundësive të reja fitimi për zonat rurale. Këto parashikime, ndoshta të tepruara,

janë përplasur me shqetësime njëlloje të tepruara. Në fakt, gjatë vitit 2007 u krijua një kritikizem i fortë lidhur me pasojat e mundshme të bioenergjisë, mbi biodiversitetin, mbi mjedisin dhe mbi rritjen e mundshme të çmimeve të drithërave që mund të ketë pasoja serioze për sa i përket sigurisë ushqimore.

Për sa i përket mjedisit, pasojat negative mund të përqendrohen në vendet tropikale, sidomos nëse merret parasysh që prodhimi mund të përqendrohet në këto zona ku ka me shumë toke në dispozicion, ku edhe të korrat mund të garantojnë rezultate me të mira. Në këtë drejtim duhet nënvizuar fakti që rreziku i zëvendësimit të ekosistemeve natyrore (pyje, zona të lageshta apo kullota) me bime të kultivuara për prodhimin e energjisë do të mbetet i lartë derisa vlera ekonomike e ambientit nuk do të njesohet plotësisht nga tregu.

Efektet tjetër të mundshëm negativ i përdorimit të biomasave për qëllime energjetike është i lidhur me rritjen e çmimit të drithit. Ky shqetësim shfaqet sidomos pas rritjes së viteve të fundit të regjistruar si në prodhimin ashtu edhe në çmime. Sipas raportit OCSE-FAO mbi perspektivat bujqësore 2007-2016, prodhimi botëror i drithit për vitin 2007 tejkaloi 2 milion tone, ku rritja me e madhe është shënuar në drithërat dytesore. Nder to dallohet rasti i misrit në SHBA, i cili ka një rritje prej 4,6 % nga viti 2006. Rritet prodhimi, por vazhdojnë të rriten edhe çmimet. Në rastin e SHBA, ndër prodhuesit me të mëdhenj të misrit, një nder shkaqet mund të kërkohet në rritjen e kërkesës së misrit nga biorafinerite, e cila kaloi nga 54 milionë tone të vitit 2006 në 81 tone për vitin 2007. Në të njëjtin perfundim arrin edhe raporti i OCSE – FAO.

## 4. Biomasat; një kuadër referimi në nivel evropian

Politika energjetike është një argument thelbësor për BE, që prej vitesh u është përkushtuar burimeve të ripërtëritshme dhe teknologjive energjetike efektive me referim të veçante në biomasat, siç tregojnë edhe strategjia e përpiluar për biokarburantet në 2006. Ky impenjim del edhe me i qarte nëse konsiderohet reforma e fundit (2003) e Politikës së Përbashkët Bujqësore, e cila mes të reja kryesore prezanton edhe ndërhyrjen e ndihmave specifike (45 euro/ha) për bimët bujqësore energjetike.

Në një moment të parë, sipërfaqja maksimale që mund të përfitonte nga ndihmat për bimët energjetike ishte 1,5 milion ha mbi të gjithë territorin e BE-se. Me hyrjen e 10 vendeve të reja në vitin 2004, KE e ka parë të udhës të shtrijë ndihmat edhe në 8 nder këto 10 vende, duke zgjeruar kështu sipërfaqen e destinuar për ndihma deri në 2 milion ha. Ky regjim ka filluar të jetë operativ në vitin 2004, kur sipërfaqja e interesuar ka arritur 2,84 milion ha, duke tejkaluar në këtë mënyrë kufirin maksimal të caktuar nga Komisioni dhe duke imponuar një shkurtrim të ndihmave. Me shfaqjen e këtij shkurtrimi sipërfaqja për të cilën çdo fermer mund të beje kërkesë

për ndihme është reduktuar proporcionalisht nëpërmjet aplikimit të një koeficienti që mund të garantojë cakun maksimal të 90 milion eurove. Në këtë mënyrë, në baze të zhvillimeve të viti 2007 fermerët do të marrin një kontribut prej 45 euro për ha për pak me shumë se 70 % të sipërfaqes për të cilën do të behet kërkesë.

Vendosja e këtyre subvencioneve ka për qëllim arritjen e disa objektivave ambicioze që BE-ja i ka caktuar vetes në lenden e burimeve të ripërtëritshme. Sot, 4 % e nevojës energjetike komunitare mbulohet nga biomasat; nëse do të shfrytëzohej potenciali i plote i këtij burimi, deri në vitin 2010 kjo vlerë mund të dyfishohet. Nder të tjera, disponibiliteti i biomasave është shtuar me hyrjen e Bullgarisë e Rumanisë, shtete që kane 0,7 ha terren bujqësor për banor, kundrejt 0,4 të BE-se 25. Sidoqoftë, KE mendon që brenda vitit 2010 të arrihet në një përdorim të biomasës për një maksimum të 150 Mtep (milion ton të njevleshem naftë), nivel me i vogël se potenciali tërësor, por afër objektivit të vene.

Pozicioni i KE ndaj biomasave është kritikuar shpesh për shkak të efekteve të mundshme shtrembëruese, gjeneruar nga mbështetja dhënë bimëve bujqësore energjetike.

## 5. Përdorimi i biomasave si burim parësor energjetik në Vendet e Pellgut të Adriatikut dhe Jonit: rasti BiomAdria

Prodhimi i energjisë së pastër e të përsëritshme nëpërmjet përdorimit të biomasave të siguruara nga produktet e mbetura prej shfrytëzimit të pyjeve, bujqësisë etj., mund të përfaqësojë një pikënisje për një seri veprimtarish të lidhura me drejtimin e pasurisë pyjore, mbrojtjen e biodiversitetit, përzgjedhjen e produkteve dhe teknikave bujqësore, me synim krijimin e burimeve alternative të ardhurave për fermerët dhe pronarët e ngastrave pyjore. Këto konsiderata janë me rëndësi të veçantë në zona ku territori, për arsye historike e gjeografike, përbën një burim strategjik. Ky është rasti i Pellgut Adriatik-

Jonian e është edhe më specifik për Ballkanin Perëndimor, ku zhvillimi rural dhe mbrojtja e mjedisit përfaqësojnë sfida të rëndësishme në rrugën drejt procesit të integritimit me BE.

Ky është konteksti në të cilin vendoset projekti BiomAdria, i cili, në mënyrë koherente me politikën evropiane, synon të kontribuojë në ndjekjen e një politike zhvillimi të qëndrueshëm në Vendet e Adriatikut, duke iu referuar në veçanti aspekteve që lidhen me nevojën energjetike dhe me mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit. Për këtë qëllim, projekti përshkruan zhvillimin e burimeve energjetike të ripërtëritshme me ndikim të ulët mjedisor (nëpërmjet zvogëlimit të varësisë nga burime energjetike të paripërtëritshme nga importi) falë përdorimit gjithnjë në rritje të burimeve energjetike endogjene, si dhe nëpërmjet përdorimit të mbetjeve bujqësore për prodhimin e energjisë.

Objektivat e projektit janë gjithashtu me rëndësi nëse do të marrim në konsideratë bilancin energjetik të Ballkanit Perëndimor (Tabela 1), të karakterizuar nga një përdorim i ulët i burimeve të ripërtëritshme, një përdorim masiv i burimeve me prejardhje fosile si edhe një varësi e madhe nga importet, edhe pse me karakteristika të ndryshme sipas vendit.

BiomAdria, që në këtë stad të projektit, edhe pse ruan një perspektivë rajonale dhe transnacionale, ka të bëjë në veçanti me disa rajone të Serbisë, kërkon të veprojë si në nivelin institucional ashtu edhe në nivelin e sipërmarrjeve. Nëse nga njëra anë i jepet rëndësi e madhe shkëmbimit të praktikave të mira në fushën e politikave energjetike, nga ana tjetër shihet me vëmendje të madhe analiza e kushteve të fizibilitetit ekonomik të ngritjes së një impianti pilot për përdorimin e biomasave (nëpërmjet djegies së drejtpërdrejt të burimit parësor) me përmasa të vogla (3-5 MW), i cili mund të jetë i përsëritshëm jo vetëm në territorin e synuar por në përgjithësi në Ballkanin Perëndimor.

Vlen gjithashtu të nënvizohet se qëndrueshmëria mjedisore e projektit garantohej edhe nga zgjedhja e llojit të mbetjeve bujqësore të përdorur, e jo

të bimëve bujqësore të përdorura, duke kërkuar kështu aktivizimin e një mekanizmi virtual që bën të mundur shtimin e vlerës së proceseve prodhuese ekzistuese, duke prodhuar një vlerë të shtuar.

## 6. BiomAlba: potenciali i një zinxhiri biomase në Shqipëri

Shqipëria është futur tashmë në debatin e politikave energjetike në një pozicion tepër të pafavorizuar, si në raport me BE, ku aspiron të anëtarësohet, ashtu edhe në raport me kontestin rajonal, duke marrë në konsideratë krizat e shumta energjetike që kanë goditur vendin e që kanë ndikuar negativisht mbi veprimtaritë prodhuese.

Në nivel kombëtar, prodhimi vjetor mbështetet në hidrocentrale, të cilat garantojnë vetëm 100 GWh, e që vitet e fundit, jo vetëm nuk arrin t'i përgjigjet rritjes së kërkesës, por është dashur të përballlet me vështirësi të dukshme, për shkak të periudhave të përsëritura të thatësirës. Edhe gjendja e sektorit të naftës duket veçanërisht e vështirë. Konsumi në rritje i naftës dhe benzinës në sektorin e transportit e ka tejkaluar ofertën e brendshme dhe ka përshpejtuar ndjeshëm rritjen e importeve. Në të njëjtën kohë, prodhimi i brendshëm është zvogëluar, qoftë për mungesë fondesh, qoftë për shterimin natyror të burimeve që mund të nxirren.

Në këtë kompleksitet, siç tregojnë edhe krizat e shumta që kanë goditur vendin vitet e fundit, prodhimi energjetik shqiptar rezulton pak i diversifikuar, gjithnjë e më i varur nga nafta e importit. Rrjedhimisht, pavarësisht se ekzistojnë pak përvoja në këtë sektor (shpesh të penguar nga mungesa e investimeve fillestare dhe të dobësuar nga një politikë energjetike afatgjatë), energjitet e ripërtëritshme bëhen një zgjedhje strategjike e domosdoshme për ta drejtuar vendin drejt arritjes së standardeve ekonomike e sociale që do të lejojnë përshtatimin e rrugës së integritimit evropian.

Në këtë vështrim përfshihet edhe projekti BiomAlba, një projektim i natyshëm në nivel rajonal i BiomAdria.

Vijon në fq. 7

Tabela 1 - Bilanci energjetik 2005 (të dhëna në ktoc: ekuivalenti në mijë ton naftë)

		Karbon	Naftë bruto	Naftë	Gaz	Bërtha natyror	Energji mor	Energji hidrolike	Lëndë gjeotermike	Energji djegëse të tjera	Gjithsej elektrike
Shqipëria	P	22	443	0	14	0	462	2	230	0	1173
	I	3	0	1194	0	0	0	0	0	32	1229
	E	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Bosnje-Herzegovina	P	2691	0	0	0	0	469	0	182	0	3343
	I	0	0	1319	336	0	0	0	0	187	1873
	E	0	0	0	0	0	0	0	0	-308	-308
Kroacia	P	0	1034	0	1865	0	545	1	355	0	3800
	I	608	4344	1196	926	0	0	0	0	752	7827
	E	0	0	-1952	-365	0	0	0	0	-313	-2629
Maqedonia	P	1170	0	0	0	0	128	12	151	0	1461
	I	111	981	283	63	0	0	0	0	138	1576
	E	0	0	-332	0	0	0	0	-1	0	-333
Serbia dhe Mali i Zi <sup>1</sup>	P	8626	622	0	228	0	1035	0	903	0	11414
	I	157	3544	439	1707	0	0	0	0	581	6427
	E	-129	0	-205	0	0	0	0	-100	-748	-1182

P = Prodhim; I = Import; E = Eksport

<sup>1</sup> Që nga 3 Qershor 2006, Mali i Zi është shtet i pavarur.

Burimi: International Energy Agency Statistical Database

# Rritja e koeficientit të përdorimit të materialit drunor neto, domosdoshmëri për ruajtjen e pyjeve

Msc. Ing. DORIZ MARJANI

Materiali drunor është prodhim natyral i drurëve pyjorë e frytorë, që rritet e zhvillohet në kushte klimatike e tokësore në përshtatje me llojin e drurit. Materiali drunor është ndër më të vjetrit, i përdorur nga shoqëria njerëzore në të gjitha etapat e zhvillimit të saj.

Vendi ynë ka patur dhe ka një kulturë shumëvjeçare në përdorimin dhe përpunimin e drurit. Përpunimi i drurit tek ne nuk lindi në mënyrë spontane, por i ka kaluar të gjitha fazat e zhvillimit.

Zhvillimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i proceseve teknologjike, rritja e shkallës së mekanizimit të fazave të procesit dhe parametrave teknologjikë të çojnë në përdorimin sa më racional e të plotë të materialit drunor, që nga prerja në pyje e deri në prodhimet e gatshme prej druri, duke marrë nga e njëjta lëndë e parë sa më shumë prodhime të gatshme, duke rritur koeficientin e përdorimit të lëndës së parë dhe duke ndikuar në barazimin e rritjes vjetore të pyjeve me prerjet vjetore të tyre.

Koeficienti i rendimentit të dobishëm të materialit drunor, i cili luan rol në përcaktimin e konsumit specifik të prodhimit të lëndës së sharruar, jepet në relacionin:  $\zeta = A - B$  në të cilin:  $\zeta$  - Koeficienti i rendimentit të dobishëm në %; A - Sasia e lëndës së drurit në formë trupash në %; B - Sasia e mbeturinave nga prodhimi i dërrasës në %.

Nga provat e bëra del se sasia e mbeturinave nga prodhimi i lëndës së sharruar për lëndën e pishës është 33 % dhe për atë të ahut 38 %.

Sipas provave koeficienti i rendimentit të dobishëm për lëndën e pishës është:  $\zeta = 100 - 33 = 67$  %, kurse për atë të ahut:  $\zeta = 100 - 38 = 62$  %.

Koeficienti i rendimentit të dobishëm është tregues nga i cili llogaritet konsumi specifik i lëndës drusore në  $m^3$  lëndë e parë për  $m^3$  prodhime të ndryshme me bazë lëndë e drurit. Konsumi specifik ( $K_s$ ) llogaritet sipas relacionit:

$$K_s = \frac{A}{\zeta} \quad \text{në } m^3 \text{ trup} / m^3 \text{ lëndë e sharruar, ku:}$$

$K_s$  = konsumi specifik; A = Sasia e lëndës së drurit në formë trupash në %;  $\zeta$  = koeficienti i rendimentit të dobishëm në %.

- Konsumi specifik i lëndës së parë për prodhimin e lëndës së sharruar të pishës:

$$K_s = \frac{100}{67} = 1.5 \text{ } m^3 \text{ trup} / 1 \text{ } m^3 \text{ lëndë e sharruar}$$

- Konsumi specifik i lëndës së parë për prodhimin e lëndës së sharruar të ahut:

$$K_s = \frac{100}{62} = 1.6 \text{ } m^3 \text{ trup} / 1 \text{ } m^3 \text{ lëndë e sharruar}$$

Mesatarisht del se konsumi specifik për prodhimin e lëndës së sharruar është 1,5 - 1,6  $m^3$  trupa për 1  $m^3$  lëndë të sharruar, çka do të thotë se për 1  $m^3$  prodhim të lëndës së sharruar mbeten 0,5 - 0,6  $m^3$  material drunor në formë e mbeturinave pa u shfrytëzuar për prodhime të tjera.

Në prodhimin e kompesatos koeficienti i rendimentit të dobishëm sipas relacionit është:  $\zeta = 100 - 61,64 = 38,36$  %.

$$K_s = \frac{100}{38,36} = 2.6 \text{ } m^3 \text{ trup} / 1 \text{ } m^3 \text{ kompesato}$$

Pra për prodhimin e 1  $m^3$  kompesatoje mbeten 1,6  $m^3$  mbeturina pa u përdorur për prodhime të tjera.

Në përdorimin e lëndës së sharruar për prodhime të mbaruara prej druri veprimi është i njëjtë. Rendimenti i

dobishëm sipas relacionit është:  $\zeta = 100 - 48 = 52$  %, kurse

$$K_s = \frac{100}{52} = 1.92$$

Pra, 1.92  $m^3$  dërrasë / 1  $m^3$  objekte të mbaruara prej druri, d.m.th. për çdo objekt të mbaruar prej druri mbeten 0,9  $m^3$  mbeturina pa u përdorur për prodhime të tjera. Siç del nga sa trajtuam, koeficienti i përdorimit të drurit në vendin tone ndikohet nga konsumi specifik i prodhimeve përkatëse.

Koeficienti i përdorimit të materialit drunor llogaritet me relacionin:

$$Kp = \frac{V_1}{V_2} \times 100 \text{ në } \%, \text{ ku:}$$

$Kp$  = koeficienti i përdorimit të materialit drunor;  $V_1$  = Volumi i lëndës së përpunuar;  $V_2$  = Volumi i lëndës së parë e përdorur.

Koeficienti i përdorimit të materialit drunor pa përdorur mbeturinat teknologjike sipas asortimenteve të prodhimeve prej druri në vendin tone është:

**A. Në prodhimin e lëndës së sharruar.** Nga 1,6  $m^3$  trup prodhohen 1  $m^3$  lëndë e sharruar dhe 0,6  $m^3$  mbeturina teknologjike (sipas konsumit specifik të prodhimit të lëndës së sharruar). Këto të dhëna i vendosim në relacionin:

$$Kp = \frac{1 \text{ } m^3}{1,6 \text{ } m^3} \times 100 = 62,5 \text{ } \% \text{ koeficienti i përdorimit}$$

**B. Në prodhimin e kompesatos.** Nga 2,6  $m^3$  trupa prodhohen 1  $m^3$  kompesato dhe 1,6  $m^3$  mbeturina teknologjike (sipas konsumit specifik të prodhimit të kompesatos). Këto të dhëna i vendosim në relacionin:

$$Kp = \frac{1 \text{ } m^3}{2,6 \text{ } m^3} \times 100 = 38,36 \text{ } \% \text{ koeficienti i përdorimit}$$

**C. Në prodhimin e parketit.** Nga 1,9  $m^3$  dërrasë ahu përfitohet 1  $m^3$  parket dhe 0,9  $m^3$  mbeturina teknologjike. Këto të dhëna i vendosim në relacionin:

$$Kp = \frac{1 \text{ } m^3}{1,9 \text{ } m^3} \times 100 = 52 \text{ } \% \text{ koeficienti i përdorimit}$$

**Rritja e koeficientit të përdorimit të materialit drunor duke përdorur mbeturinat teknologjike**

A. Në prodhimin e lëndës së sharruar:

- Për 1  $m^3$  lëndë e sharruar konsumohen 1,5  $m^3$  trupa, ç'ka do të thotë se nga 1,5  $m^3$  trupa prodhohen 1  $m^3$  dërrasë dhe mbeten 0,5  $m^3$  mbeturina.

- Nga 0,5  $m^3$  mbeturina prodhohen 0,33  $m^3$  pllakë zdrukthi, d.m.th. se nga 1,5  $m^3$  trup prodhohet 1  $m^3$  dërrasë + 0,33  $m^3$  pllakë zdrukthi = 1,33  $m^3$ . Këto të dhëna i vendosim në relacionin:

$$Kp = \frac{1,33 \text{ } m^3}{1,5 \text{ } m^3} \times 100 = 88 \text{ } \%$$

Pra, duke përdorur mbeturinat teknologjike kemi një rritje të koeficientit të përdorimit të drurit nga 62 në 88 %, d.m.th. një rritje prej 88 - 62 = 26 %.

B. Në prodhimin e kompesatos:

- 1  $m^3$  kompesato konsumon 2,6  $m^3$  trup dhe mbeten 1,6  $m^3$  mbeturina.

- 1,6  $m^3$  mbeturina që mbeten nga prodhimi i kompesatos prodhohet 1  $m^3$  pllakë zdrukthi, fibre apo M.D.F-je, që do të thotë se nga 2,6  $m^3$  trupa rritet sasia e

prodhimit nga 1 në 2  $m^3$  (1  $m^3$  në formë kompesato dhe 1  $m^3$  pllakë zdrukthi).

Duke përdorur relacionin e koeficientit të përdorimit të materialit drunor do të kemi:

$$Kp = \frac{V_1}{V_2} \times 100 \text{ në } \% = \frac{2 \text{ } m^3}{2,6 \text{ } m^3} \times 100 = 77 \text{ } \%$$

Ç'ka do të thotë se rritja e koeficientit të përdorimit të materialit drunor në prodhimin e kompesatos kur përdoren mbaturinat teknologjike si lëndë e parë për prodhimin e pllakave të zdrukthit që rritet në 36,64 % d.m.th. 77 % - 38,36 = 36,64 %.

C. Në prodhimin e parketit, dyerve, dritareve dhe objekteve të tjera prej druri:

- Konsumi specifik i dërrasës që prodhohet për parket është 1,91  $m^3$  dërrasë për 1  $m^3$  parket.

- 0,91  $m^3$  mbetje teknologjike: 1,6  $m^3$  konsum specifik të prodhimit të pllakave të fibrës do të kemi 0,6  $m^3$  pllakë fibre. Koeficienti i përdorimit do të jetë:

$$Kp = \frac{V_1}{V_2} \times 100 \text{ në } \% = \frac{1 \text{ } m^3 + 0,6 \text{ } m^3}{1,91 \text{ } m^3} \times 100 = 84 \text{ } \%$$

Koeficienti i përdorimit në prodhimin e artikujve të përmendur më lart, duke përdorur mbeturina teknologjike, rritet nga 52 në 84 %, d.m.th. rritet koeficienti i përdorimit të drurit 32 %, i cili arrihet duke përdorur mbeturina teknologjike të dala nga përpunimi i dërrasës së ahut si lëndë e parë për prodhimin e parketit dhe dërrasës së pishës për dyer e dritare.

Mbaturinat teknologjike kanë përmasa e prejardhje nga lloje të ndryshëm drurësh, prandaj del e nevojshme dhe e domosdoshme që këto mbeturina teknologjike të justifikojnë përdorimin si lëndë e parë për prodhimin e pllakave të zdrukthit, fibrës, M.D.F-së dhe parketit të melaminuar, mbi bazën e të cilëve llogaritet rritja e koeficientit të përdorimit të materialit drunor dhe rritja e tij kur përdoren mbeturina teknologjike të trajtuara më lart.

Duke shfrytëzuar literaturën e specialitetit dhe përvojën e prodhimit të pllakave të zdrukthit e fibrës para vitit 1991, mbaturinat teknologjike të materialit drunor të rezultuara nga përpunimi i drurit pas vitit 1991 kanë të njëjtat veti fiziko-mekanike dhe plotësojnë kushtet për t'u përdorur si lëndë e parë për prodhimin e pllakave të përmendura më lart. Përveç kushteve të lëndës së parë del e domosdoshme që mbaturinat teknologjike të përpunohen duke vënë në funksionim fabrikat e kompesatos, fibrës dhe pllakave të zdrukthit, të cilat janë në ish-Kombinatit të drurit, Elbasan.

Efektet e rritjes së koeficientit të përdorimit të materialit drunor në ekonomizimin e fondit pyjor, sipas llogaritjeve, është:

- Nga 200.000  $m^3$  trupa që priten në pyje për prodhimin e lëndës së sharruar, kompesatos, rimesos, parketit dhe përpunimit të lëndëve të përmendura më lart deri në objekte të mbaruara prej druri, dalin 120.667  $m^3$  mbeturina, nga të cilat, duke i përdorur si lëndë e parë, prodhohen 80.445  $m^3$  pllaka zdrukthi, fibre dhe M.D.F-je, duke zëvendësuar keshtu lëndën e sharruar, kompesaton, rimeson, dërrasën për parket, etj.

Nga zëvendësimi i lëndës së sharruar me atë të pllakave të prodhuara do të kemi: 80.445  $m^3$  pllaka zdrukthi x 1,6  $m^3$  (koeficienti specifik i lëndës së sharruar) = 120.000  $m^3$  trupa, që nuk priten në pyje dhe 120.000  $m^3$  trupa : 160  $m^3$  / ha = 716 ha pyje që nuk priten.

- Nga rritja e rrjedhshme në pyje prej 1,7  $m^3$  / ha fitohen: 716 ha x 1,7  $m^3$  trup / ha = 838  $m^3$  trupa, që i shtohen fondit pyjor.

## Vijon nga fq. 6

Nisur nga analiza e politikave energjetike e mjedisore, me vëmendje të veçantë në zhvillimin e burimeve energjetike të ripërtëritshme, BiomAlba ka për qëllim të vlerësojë potencialin e përdorimit të biomasave si burim energjetik alternativ në kontekstin shqiptar. Nëse nga njëra anë, është e nevojshme të nënvijëzohet si objektivi parësor të projektit realizimin e një studimi fizibiliteti për një zinxhir prodhimi me biomasë në Shqipëri, nga ana tjetër, është e rëndësishme të ndalemi në metodologjitë që parashikojnë përfshirjen e aktorëve vendorë (institucione kërkimore, të pushtetit vendor, sipërmarrës) dhe

realizimin e aktiviteteve trajnuese, ndërgjegjësuese, si dhe përhapjen e praktikave bashkëkohore energjetike. Qëndrueshmëria e projektit kalon sëpari nga vlerësimi në kompleks i burimeve të pranishme në territorin shqiptar, qofshin këto natyrore apo njerëzore.

Realizimi i projekteve me synim vlerësimin e burimeve vendore dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të territorit, mund të konsiderohet një kalim themelor e strategjik në identifikimin e instrumenteve për promovimin edhe implementimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm. Siç u nënvijëzua më lart, një qasje e këtij tipi është veçanërisht e rëndësishme në

zona si Ballkani Perëndimor dhe më në përgjithësi në Basenin Adriatiko-Jonian, ku vlerësimi dhe kujdesi për territorin përbëjnë një burim strategjik për zhvillimin social dhe ekonomik.

**Shënim.** Artikulli është shkruar së bashku nga të gjithë autorët, por në mënyrë specifike: A. Segrë ka koordinuar punën; E. Kullaj është përgjegjës për nënçështjen 6; R. Preka për 3 e 4; M. Vittuari për 2 e 5.

Artikulli është i pajisur me referimet përkatëse, si dhe me nje bibliografi të pasur, por redaksia e Gazetes është përpjekur ta përshtatë sa më mirë me natyrën e këtij botimi.



## International conference: Albania a competitive region

On November 21-22 at Hotel Mondial, Tiranë, it was held the international conference “*Albania: competitive region through the efficient usage of energy and protection of natural resources*”.

The conference was organized from the Foundation on Southeastern Europe of the German Ministry of Foreign Affairs and Leibniz Foundation on Geography (Leipzig-Germany), in collaboration with the ministry of Agriculture, Food, Consumer and Environment Protection of Albania. Land trip of the participants was supported from the Directorate of Forest Policy and pastures, Project of Natural Resources, national Association of

Communal Forests and Pastures, Faculty of Forest Sciences and Associations of Forests and pastures, Tregan and Sinaballaj.

The models of Tregan and that of Haverikeve forest give the message of restitution of degraded lands into grown forests within a short period and are being used for recreation, the same as the school for the increase of biomass and the reduction of land erosion. Apart the heads and the specialists of the abovementioned institutions, participated the ambassador of Germany in Albania Bernd Borchardt, the vice Minister of Agriculture, Food and Consumer Protection, Ndue Preka.

Page 1



## The meeting of Regional Association of Communal Forests and Pastures

At the conference room of Skampa International Hotel, Elbasan supported from Dutch Organization for Development SNV, it was organized the meeting “*The transfer of Community Forest Wealth empowers farmers*” The meeting aimed the evidencing of the problems arisen during the transfer of the forests and pastures at local power units.

Participants: The Board of Regional Association of Communal Forests and Pastures of Elbasan District, heads of SHPPKK form the district,



representatives of the Forest Service in the four districts of the circuit, environmentalist, forest specialists, and representatives from Forest Federations Tirana, Diber, Korçe and Kukës. There were present also representatives of MMPAU and SNV Tirana, Korçe, central and local media. The head of Elbasan Circuit Council Ardian Turku was present. We are publishing the main material presented from Ndriçim Çela, head of SHPPKK Board, Elbasan.

Ing. Fatmir BRAZHDA

Page 1, 2



## European Week on Forests

For the first time in the European continent, on October 20-24, 2008 it was held in Rome (Italy) “European Week on Forests”. Activities were held in whole Europe, by discussing the role of forests in the forest sector in the fight against climate changes, by securing renewable energy sources securing water



sources. During this event there was appreciated the need for the undertaking and usage of all the potentials of forest sector. In this meeting there were gathered about 450 participants form forest sectors, water and houses. The week marked the first meeting in policy drafting level of the forest and water sectors.

Ing Genci HOXHAI

Page 3



### KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Tiranë

Këshilli Botues:

N. Çollaku, Th. Lako, M. Kotro, J. Male, F. Memeli, A. Diku.

Kryeredaktor: AHMET OSJA

Zv.kryeredaktor: FERDIN LIÇAJ

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, Z. Ymeraj.

Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë

Mobile: 068 23 23 360; 069 21 11 333; 068 21 42 098

e-mail: velihoxha@yahoo.com

kurora\_gjelber@yahoo.com

www.shkpkk.org



The International Land Coalition is a global alliance of intergovernmental, governmental and civil-society organizations. The Coalition works together with the rural poor to increase their secure access to natural resources, especially land, and to enable them to participate directly in policy and decision-making processes that affect their livelihoods at local, national, regional and international levels.

